



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 424 , datë 2.6.2010

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT,  
ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË  
SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, pikës 2, të nenit 60, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores "Për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Përbërja, struktura, organika dhe funksionimi i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) dhe të Këshillit të Akreditimit përshtaten brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë të fillojë procedurat për kryerjen e vlerësimit të saj të parë të brendshëm, si pjesë e procesit të aplikimit për t'u bërë anëtare në Rrjetin European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, ENQA ose EQAR.

4. Vendimi nr.303, datë 1.7.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, shfuqizohet.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Akreditimit dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**



SALI BERISHA

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**MYQEREM TAJ**



NR.PROT.2141/3  
DATË 14.6.2010

PRESIDENCËS  
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
KËSHILLIT TË AKREDITIMIT  
AGJENCISË PUBLIKE E AKREDITIMIT TË  
ARSIMIT TË LARTË  
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHIA  
Sekretari i Përgjithshëm

